

Asime FERAJ
Shkolla jopublike "Internacional",
Vlorë, SHQIPËRI
Email: asimeferaj@gmail.com

**MIKROSTRUKTURA E FJALORIT SI BAZË PËR PARAQITJEN E
KUPTIMEVE NË NJË ZË LEKSIKOGRAFIK
DICTIONARY MICROSTRUCTURE AS A BASE FOR MEANING
DEMONSTRATION IN A LEXICOGRAPHIC VOICE**

Hyrje

J. Thomai jep përkufizimin “*Fjalori* është vepër gjuhësore që përmban një numër të madh fjalësh, të renditura zakonisht alfabetikisht, përkrah të cilave jepen shpjegimet për kuptimet e tyre leksikore (në fjalorët shpjegues) ose gjegjëset në gjuhë të huaj (në fjalorët dygjuhësh a shumëgjuhësh), si edhe trajtat plotësuese të fjalëve, shënimet e nevojshme gramatikore, stilistike a për fushën e përdorimit, thënie, shembuj etj. Për lëndën që përfshin një fjalor, sipas tipit, shfrytëzohen kartotekat e leksikut, të sinonimeve, të terminologjisë, të frazeologjisë, të onomastikës, të toponimisë etj., si edhe burimet e gjuhës së shkruar e të folur.”

Çdo fjalor i mirë shkencor mbështetet mbi një teori, sipas së cilës përcaktohet tipi i fjalorit nga vëllimi, nga natyra e fjalëve që përfshin, nga parimet, kriteret e zgjidhjet leksikografike që zbatohen, nga shtresimi i fjalësit sipas burimit, sipas normës ose sipas formimit, nga mënyra e shkala e zberthimit kuptimor ose nga ndërtimi i strukturës kuptimore për çdo fjalë, nga zbulimi e pasqyrimi i vlerave kuptimore, shprehëse, emocionale e stilistike të fjalëve dhe nga shumë anë të tjera.

Në këtë punim janë trajtuar dy përbërësit bazë të një fjalori shpjegues, tek të cilët do të mbështetet e gjithë puna analizuese dhe

interpretuese dhe më konkretisht te *Makrostruktura dhe mikrostruktura te fjalorët shpjegues kombëtarë*; Në pjesën e dytë të punimit ne kemi parë, *Paraqitja e kuptimeve në një zë leksikografik dhe sintagmatika e thënieve (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980; Fjalori i shqipe së sotme, 1980; Fjalori i gjuhës shqipe, 2006.*

Punimi është pajisur me *Përfundime dhe Bibliografinë e veprave shkencore të shfrytëzuara gjatë përgatitjes së tij.*

1. Makrostruktura dhe mikrostruktura te fjalorët shpjegues kombëtarë

Për të analizuar dhe për të interpretuar sintagmatikën e një fjalori së pari duhet të kemi parasysh *makrostrukturën* dhe *mikrostrukturën* e tij.

a. J. Thomai po aty shpjegon: “*Makrostruktura* është ndërtimi i fjalorit në tërësi: fjalësi (glosari, d.m.th. lista e fjalëve a e njësive frazeologjike që janë zgjedhur për t’u përfshirë në fjalor dhe që renditen sipas një kriteri), struktura kuptimore e fjalëve a e njësive frazeologjike, me trajtat plotësuese, me shënimet gramatikore, stilistike e për fushën e përdorimit, me shpjegimet e kuptimeve, me thëniet e me shembujt etj. Të gjitha këto elemente të makrostrukturës përcaktohen nga tipi i fjalorit dhe synojnë ta japin çdo njësi leksikore, frazeologjike a semantike sa më të plotë e sa më të qartë për përdoruesit e fjalorit. Kështu, makrostruktura është “ndërtesa” në tërësi e fjalorit, që ka ndarjet e pjesët e veçanta.”

1. “*Fjalori i gjuhës shqipe*”, 1954 ka rreth 25.000 fjalë.

2. “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*”, 1980 ka në makrostrukturën e vet rreth 41.000 fjalë, rreth 7.000 njësi frazeologjike.

3. *Fjalori i shqipes së sotme* ka rreth 34.000 fjalë dhe 5.000 njësi frazeologjike.

4. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 2006, ka rreth 48.000 fjalë dhe rreth 5000 njësi frazeologjike.

5. Fjalori i sinonimeve përfshin rreth 29.000 fjalë sinonimike që krijojnë 29.000 vargje e grupe sinonimike.

Por objekti i punimit tonë, nuk janë makrostrukturat e këtyre fjalorëve, por mikrostruktura, dhe brenda saj ilustrimet me shembuj.

Prof. J. Thomai shkruan se: “*Mikrostruktura* e fjalorit është ndërtimi i çdo njësie leksikografike veças, ç’përmban ai që quhet “*zë leksikografik*” a “*paragrafi i fjalës*”, d.m.th. paragrafi për një fjalë a për një njësi frazeologjike. ***Edhe mikrostruktura varet nga tipi e nga synimi kryesor i fjalorit:***

-në një fjalor të madh, që ka shumë fjalë, ka edhe zbërthim më të imët të përmbajtjes leksikore për çdo fjalë, shpjegime më të gjera për çdo kuptim, më shumë shënime plotësuese, **më shumë thënie a shembuj etj.**;

-në një fjalor të vogël, përkundrazi, që ka më pak fjalë, ka edhe më pak kuptime për çdo fjalë, shpjegimet janë më të shkurtra, **jepen më pak shënime plotësuese, thënie e shembuj etj.**

2. Paraqitja e kuptimeve në një zë leksikografik dhe sintagmatika e thënieve

Prof. J. Thomai, thotë se “Fjalori ka ndërtimin e vet të brendshëm, që përbën “*teknologjinë*” ose “*morfologjinë*” e fjalorit, sipas parimesh teorike e kriteresh praktike leksikografike: ç’fjalë do të përfshijë, sa (në ç’përpjesëtim) do të pasqyrohen shtresat e ndryshme leksikore (leksiku i përgjithshëm, leksiku konkret e ai abstrakt, leksiku krahinor, terminologjia, fjalët e huaja, neologjizmat, fjalët e vjetruara, emërtimet e kafshëve, të bimëve, të veshjeve, të mjeteve, të gatesave etj.). Kjo “teknologji” e brendshme e fjalorit sendërtohet nëpërmjet “*teknikës*” leksikografike (si do të jepen fjalët, si do të renditen e si do të shpjegohen kuptimet, **si do të shënohen vlerat e njësive që shpjegohen, si do të jepen thëniet e shembujt, si do të gërshetohen e do të pasqyrohen veçoritë leksikore, gramatikore e stilistike etj.**). “Teknika” leksikografike synon t’i japë fjalorit cilësi sa më shkencore, ta bëjë sa më ekonomik dhe lehtësisht të përdorshëm.

Fjalorët që kemi marrë në analizë janë të llojeve të ndryshme, që dallojnë ndërmjet tyre, siç kemi thënë, jo vetëm nga makrostruktura, por edhe nga mikrostruktura e zërave leksikografikë. Ky ndryshim mbartet në fjalorë edhe për thëniet (në fjalorët shpjegues kombëtarë), kurse Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, vetvetiu ndryshon sepse është fjalor jo me thënie por me shembuj.

Prof. H. Shehu shprehet se në një fjalor shpjegues thëniet kanë funksione të ndryshme sipas tij “Në një vështrim gjuhësor e veçmas leksikologjik e leksikografik më specifik përmendim: **thëniet kanë vlerë denotative** (*elektrodë pozitive* është “anodë”, *elektrodë negative* është “katodë”, *puçërr e zezë* është “plasja”; në anglishte *gërshërë delesh* është “shears” e të *kuq buzësh* është “lipstick”); **kanë vlerë konotative** (shih p. sh. kuptimet e kushtëzuara sintaksore, që lindin veçse në një kontekst të caktuar: tipi *është dhëlpër ai* etj); **thëniet diferencojnë kuptimet e fjalëve shumëkuptimshe** (*rini entuziaste* është “rini që punon me entuziazëm” / *këngë entuziaste* është “këngë që shpreh entuziazëm”; *zë i frikshëm* “të shtie frikën” / *njeri i frikshëm* është “njeri frikacak”); saktësojnë kuptimet e kryehershme (nxit *zjarrin* “i fryj që të ndizet”; kallëzuan *grunjërat* “nxorën kallëzit”; *kur shporta ka fiq, gjithë jetën e ke*

miq); **saktësojnë ngjyrimet kuptimore të sinonimeve** (krahaso ndajfoljet *shumë e tepër*); **plotësojnë informacionin që jepet në shpjegimin e glosës** (zvarranikët *pjellin vezë*); **motivojnë regjistrat shkencorë të njësive leksikore a të kuptimeve të tyre** (krahaso *pika e vlimit dhe vëmë pikë në fund të fjalisë*); ilustronjë njësitë e çerdhes fjalëformuese (krahaso *mish pa kocka s'ka dhe ind kockor; mbuloj supet me shall dhe mbulesa e tryezës / me fytyrë të mbuluar; natë e pagjumë dhe vuan nga pagjumësia; pluhur qymyri dhe pluhurzojnë qymyrin etj.*); **tek emrat prejfoljorë, thëniet shërbejnë për të dalluar veprimin, gjendjen, rezultatin** (*gjetje te gjetja e xeherorit është veprim; tek është një gjetje e bukur “zgjedhje e mirë” e te gjetje të reja arkeologjike “sendet që zbulohen gjatë gërmimeve” gjetje shënon rezultat; te gjelbërim i rrugëve shënohet veprimi; te u mbush me gjelbërim shënohet rezultati, “bimësia”; tek tërheqja dhe sulmi (si taktikë ushtarake) tërheqja është veprim dhe rrjedhim; therje te bagëti për therje është veprim; te kam therje në shpatull është rezultat, “thermë”*); **motivojnë vlerat stilistike të fjalëve a të kuptimeve të tyre** (krahaso *njom pambukun dhe e njomi me pështymë / për dikë, që i dalin cërkat e pështymës kur flet; e hëngri bukën dhe e hëngri të shkretën vajzë; ka sy të sormë dhe ka sy sorrush etj.*) **dhe tregojnë nivelin stilistik të përdorimit** (dhe fjalori e ka për detyrë të japë informacion stilistik); **veçojnë homonimet** (erë_I e butë është “juga” / erë_{II} e mirë është “ajo që ndihet me hundë”; te ndizte zjarr me erëza, “erëzat” janë “bajga të thata”; te gatesat duan erëza, erëzat janë “bimë të merme” etj.); **dallojnë paronimet** (krahaso *kryetari i bashkisë dhe kryetari i bashkësisë; njeri i ndershëm dhe njeri i nderuar*); veçojnë njësitë paronomazike (krahaso *muzikë shekullare dhe muzikë shekullore; mëshiroj të varfrit dhe dashurinë për të varfrit e mishëron në poezinë e tij*); **mbështesin dhe plotësojnë barasvlerësit në një fjalor dygjuhësh** (krahaso, p. sh. *sapun i butë “soft soap” dhe klimë e butë “mild climate”*) etj.

Ne po japim për ilustrim pasqyrimin e fjalës *ditë* (si *fjalë e shqipes që e ka trashëguar nga ilirishtja dhe që i përket fondit indoevropian*) në FGjSh (1954) në FGjSSh (1980), në FShS (1984/2002) dhe FGjSH (2006), duke dhënë më parë edhe kriterin e mënyrën e pasqyrimin të thënieve në secilën vepër. Për këtë jemi mbështetur në Parathëniet e secilit.

2.1 Fjalori i gjuhës shqipe, 1954

Në Parathënien e Fjalorit thuhet, ndër të tjera, “Për të sqaruar më mirë kuptimin e fjalëve dhe për t’illustruar përdorimin e tyre, spjegimi shoqërohet shpesh më shembëlla dhe frazeologji. Shembëllat jepen pas spjegimit të kuptimit me të cilin lidhen, duke u ndarë prej tij me dy pika (:), dhe **janë fjali e fraza të shkurtër ose shprehje**. Kur shprehja

frazeologjike ndahet me pikëpresë e jo me dy pika prej një kuptimi, do të thotë se nuk është ilustrim i drejtpërdrejtë i tij.”¹

DITË-A ef, shm. dit koha midis të lindurit dhe të përnduarit të diellit; **ant. natë**; kohë njëzet e katër orësh e llogaritur prej mesnate derin në mesnatë; - **e kremte**; - **e lëvruame**, ditë pune, ditë punëtoare; - **pazari**; **për -**, - **për -**, çdo ditë; -**a -ës**, çdo ditë; **një - prej ditësh**, një ditë; **në - të keqe**, në hall; - **e bardhë**, lumturi, ditë e lumtur; **ant. - e zezë**; **ka dit**, ka shumë kohë; **gjithë -n e -s**, tërë ditën; **një - udhë**; **çështje e -s**, çështje aktuale; - **e verës**, dita që në popull konsiderohet si fillimi i verës, festë e popullit.

2.2 Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980

Në *Shpjegime për ndërtimin e Fjalorit* thuhet se çdo fjalë në “Fjalor” trajtohet si një njësi e pandarë leksiko-semantike e fonetiko-gramatikore dhe formon një artikull të veçantë me kuptimet e përdorimet e saj.

Pjesa e parë e çdo artikulli përfshin fjalën në trajtën përfaqësuese e në trajtat e saj përfaqësuese, shpjegimet e kuptimit të fjalës dhe **thëniet për çdo kuptim**. Pjesa e dytë përfshin frazeologjinë gjuhësore e të ashtuquajturën frazeologji letrare, bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore, emërtimet e pathjeshta dhe togje të tjera, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta e të qarta në kohën e sotme me asnjë nga kuptimet e shpjeguara në pjesën e parë.

Kuptimet e fjalëve dëshmojnë me thënie, që plotësojnë a sqarojnë më mirë shpjegimet e fjalëve, tregojnë lidhjet e mënyrën e përdorimit të tyre etj. Ato renditen sipas kuptimit e ndërtimit; p.sh., tek emrat më parë vihen thëniet që shënojnë llojet e sendet a të dukurisë dhe që janë zakonisht **emër + mbiemër** (si *bota bimore*, *çorape të leshta*, *bar i njomë*, *pjatë e nderë*, *fill i dredhur* etj.), thëniet **emër + emër** (si *qumësht lope*, *fletë ndëri*, *mish viçi*, *vaj ulliri*, *fole milingonash*, *gotë rakie*, *kripë gjelle*, *sapun rrobash* etj.) dhe thëniet **emër + parafjalë + emër** (*gjalpë pa kripë*, *këpucë me qafa*, *rrobaqepësi për gra* etj.). Pastaj vijnë thëniet për pjesët e sendit ose për veprimet që lidhen me të dhe që zakonisht përbëhen nga **emër + fjala e shpjeguar**, si *dorëza e parmendës*, *halat e grurit*, *gryka e pusit* etj.), thëniet me marrëdhënie kundrinore që përbëhen nga **folje + emër**, si *pres dru*, *ndez zjarrin* etj.

Si thënie janë vënë edhe disa njësi frazeologjike ose fjalë të urta që lidhen më kuptimin përkatës. Në raste të tilla shpjegimi i kuptimit plotësohet zakonisht me shënimin “edhe në një varg njësisish frazeologjike”. Më rrallë janë vënë si thënie fjali të plota, vargje të shkëputura ose pjesë nga

¹ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, f. VI

dialogë, që jepen në mes dy katrorësh; p.sh., *Kriza është bashkudhëtare e pashmangshme kapitalizmit (te bashkaudhëtar/e-ja. Ky i bekuar shi i prishi të lashtat (te bekuar (i,e). -Nesër do të shkosh? – E, nesër.*

Gjymtyrët e një tipi, me të cilat mund të lidhet një fjalë për të formuar thënie të ndryshme, vihen në kllapa, pa përsëritur fjalën kryesore; p.sh. *Anë e mbarë (e prapme, e pasme). Ajka e qumështit (e gjellës, e kafesë). Raki (verë) e ashpër. Mollë (dardhë) e ëmbël. Era e malit (e fushës). Nuk bashkohen në këtë mënyrë gjymtyrët që kanë përmbajtje e ngjyrim krejt të kundërt, si *Njeri i mirë (i ndershëm, i drejtë). Njeri i keq (i lig, i poshtër, gënjeshtar...)* etj. ose që formojnë emërtime të pathjeshta (*Brumbulli i murrmë, Brumbulli i gjelbër, Brumbulli i miellit* etj.).*

DIT/Ë, ~A f. sh. ~Ë, ~ËT. 1. Koha kur lind dielli e derisa perëndon, koha që kur gdhin e derisa ngryset; drita e diellit gjatë kësaj kohe; moti gjatë kësaj kohe; *kund. natë. Ditë e gjatë (e shkurtër). Ditë të bukura. Ditë të kthjellëta (të vrenjtura). Ditë e ftohtë (e nxehtë). Gjithë ditën e ditës nga mëngjesi deri në mbrëmje. Gjatë ditës. Fillimi (mesi, mbarimi) i ditës. Zgjatet (rritet, shkurtohet, zvogëlohet) dita. Mori dita u rrit, u zgjat. U thye dita kaloi mesdita, erdhi pasdrekja. Është ditë. U bë ditë u gdhi. Iku (u ngrys) dita u ngrys. Me ditë me dritë dielli, pa u errur. Pa hapur (pa gdhirë, pa zbardhur) dita. Sa pa rënë dita. E bëri ditë. Ditë me re (me shi, me diell). Dita e mirë duket që në mëngjes. fj.u.*

2. Koha prej njëzet e katër orësh, gjatë së cilës Toka bën një rrotullim të plotë rreth boshtit të vet; koha prej njëzet e katër orësh, që llogaritet zakonisht prej mesnate në mesnatë dhe që merret si masë. *Ditë kalendarike. Ditë diellore* koha nga një mesditë në mesditën tjetër. *Ditë hënore* kohë prej katërmëdhjetë ditësh. *Ditët e vitit (e muajit, e javës). Para (pas) disa ditësh. Kaluan edhe dy ditë. Mbushi pesë ditë foshnja. Ka shumë ditë që s'e kam parë. Është punë (çështje) ditësh* do të kryhet, do të arrihet etj. së shpejti.

3. Një kohë e caktuar brenda javës, muajit a vitit, gjatë së cilës kryhet a vazhdon një punë, një veprimtari; koha e zënë ose jo me një punë a veprimtari; koha e punës brenda njëzet e katër orëve; puna që bëhet gjatë kësaj kohe. *Ditë e lodhshme (e ngarkuar, e qetë). Ditë pune. Ditë mësimi. Ditë punëtore. bised. ditë pune. Ditë aksioni. Ditë pazari. Ditë pushimi. Ditë feste. Dita e punës. Dita e pastrimit. Nxënës (student) i ditës. Shërbimi i ditës. Roja e ditës. Paguhet për ditën e sotme (e djeshme, e nesërme). I shkoi (i iku) dita. Ka munguar pesë ditë. Ka bërë dy ditë me shumë. Do (kërkon) dy ditë kjo punë. E paguante me ditë.*

4. *bised. Paga për punën brenda njëzet e katër orëve, page ditore. Ditë e plotë. I dha (ia preu) ditën. I ecte dita. E kishte ditën të ulët (të lartë).*

5. Një date kalendarike, e cila lidhet me një ngjarje të caktuar. *Ditë e shënuar. Dita e themelimit të Partisë (e Çlirimit, e Pavarësisë). Dita e*

Mësuesit (e Gruas, e Pionierit, e Fëmijëve, e Ushtrisë, e Shtypit, e Dëshmorëve). Dita e 1 Majit. Dita e Verës, etnogr. dita e pare e marsit, kur festohet ardhja e pranverës, kryemoti. Dita e stërvitjes (e provimit). Dita e lindjes. Dita e martesës. Dita e zgjedhjeve. Dita e pashkës (e bajramit). fet. Dita e takimit me prindërit. Ditë zie. Caktuan (prenë) ditën. Kam ditën për kontroll (për vizitë).

6. *vet. sh.* Pjesë e një periudhe të jetës së njeriut, të një epoke etj.; koha që lidhet me një moshë, me një epokë a me një periudhë të caktuar; vetë kjo moshë, kjo epokë a kjo periudhë. *Ditët e rinisë (e pleqërisë, e vajzërisë, e djalërisë). Nën ditët tona në kohën tonë; në kohën e sotme. Në ato ditë. Ishin ditë të bukura (të rënda, të vështira, të gëzuara, të stuhishme të arta).*

7. *kryes. sh.* Koha sa jeton dikush; jeta e njeriut. *I ngrysi ditët. Shtynte ditët. I ka ditët të numëruara edhe pak ditë i kanë mbetur që të rrojë, do të vdesë Së shpejti. Marrsh nga ditët e mia! ur. Iu nxiftë dita! (iu nxifshin ditët!). mallk. Tu preftë (t'u shkurtoftë) dita! mallk.*

8. Masë popullore për kohën sa zgjat një udhëtim, një punë etj. *Tri ditë udhë me këmbë (me kale). Duhet dhjetë ditë punë për të bërë murin (për të hapur kanalën, për të lëruar arat).*

9. Kohë e pacaktuar; çast, kohë. *Një ditë njëherë, dikur. Një ditë prej ditësh njëherë, dikur. Një ditë të bukur një ditë prej ditësh. Që ditën... Ditën që... Edhe sot e kësaj dite deri tani, deri (me) sot. Sot e gjithë ditën. Do të vijë dita kur... Do të vijë ajo ditë. Ia gjeti ditën dikujt ia gjeti rastin a çastin me të volitshëm për t'i thënë, për t'i dhënë a për t'i kërkuar diçka, për ta dëmtuar a goditur etj.*

10. *si mb.* DITËS (i, e). Që i përket pikërisht kohës sonë, që lidhet me periudhën kur jetojmë; që ka rëndësi tashti, që vlen a përdoret tashti ose që duhet zgjidhur sa më parë; që është bërë brenda ditës e që është caktuar për atë ditë. *Çështje e ditës. Detyrë e ditës. Këngë të ditës. Gjellë të ditës. E vlerësonte si problem të ditës. S'është e ditës.*

★ **Nga dita në ditë** a) shumë shpejt, në njërin prej ditëve me të afërme, së afërmi; b) për çdo ditë që kalon, nga njëra ditë në tjetrën. **Ditë e natë** vazhdimisht, pa pushim. **Në ditë të pikës shih te PIK/Ë, ~A. Në mes (në pikë) të ditës** sheshit; hapur. **Ia preu ditën (orën, jetën) dikujt shih te PRES₁. Rendi i ditës shih te REND, ~I₁₁. Në sy të ditës shih te SY, ~RI₉. Úrdhër dite shih tek URDH/ËR, ~RI₂. Ç'je bërë në këtë ditë!** ç'arrite në këtë gjendje të keqe!, ç'je katandisur kështu! **T'u bëftë dita një mijë!** ur. t'u zgjattë jeta, rrofsh e qofsh sa malet! **S'i ka bërë ende ditët** edhe *mospërf.* është ende i vogël e pa përvojë, s'është bërë ende për diçka. **E bëj natën ditë shih te NAT/Ë, ~A. Bli ditë e shko shih te BLEJ. Është në ditë të errët shih tek ERRËT (i, e). Ishte në ditë (në pikë) të hallit shih te HALL, ~I. Është në ditët e veta** është gati të lindë, do të lindë së

shpejti (për gruan shtatzënë). **Janë (ndryshojnë) si nata me ditën shih te NAT/Ë,~A. Është (vë, mbetet) në rendin e ditës shih te REND,~I II. S'ka dasmë çdo ditë (për ditë)ff.u. shih te DASM/Ë,~A. I ka ditët të shkurtra shih te SHKURTËR (i, e). Më tepër ditë se kuleç është në gjendje të vështirë eko-nomike, nuk i del buka. Erdhi dita e tij erdhi koha e çasti kur dikush mund të plotësojë dëshirat a qëllimet që ka pasur a kur dikush bëhet i fuqishëm, i pushtetshëm. Kur të bëhen dy ditë bashkë iron, asnjëherë, kurrë. Dita ka sy e nata ka veshë ff. u. shih te VESH,~I. Kush ka ditën të mos presë mesditën ff. u. dita do shfrytëzuar që në mëngjes, s'duhet shtyrë puna për me vonë. Paraja e bardhë për ditë të zezë vjet. shih te PARA,~JA. S'shëndoshet (s'majmet) kau ditën që do të theret ff. u. shih te KA,~U. Ditë polare pjesë e vitit në zonat a rrethet polare, gjatë së cilës Dielli nuk perëndon për afro një gjysmë viti.**

2.3 Fjalori i shqipes së sotme, 1984 / 2002

Në *Shpjegime për përdorimin e Fjalorit* thuhet se çdo fjalë në “Fjalor...” trajtohet si një njësi e pandarë fonetiko-gramatikore e leksiko-semantike dhe formon një artikull më vete me kuptimet e përdorimet e saj.

Pjesa e parë e çdo artikulli përfshin fjalën në trajtën përfaqësuese e trajtat e saj përfaqësuese, shpjegimet e kuptimit të fjalës dhe **thënie** për **çdo kuptim**. Pjesa e dytë përfshin frazeologjinë, emërtimet e pathjeshta bashkëlidhjet e qëndrueshme gramatikore dhe togje të tjera, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta e të qarta në kohën e sotme me kuptimet e shpjeguara në pjesën e parë.

Kuptimet e fjalëve dëshmohen me thënie, që plotësojnë a sqarojnë më mirë shpjegimet e fjalëve, tregojnë lidhjet e mënyrën e përdorimet e tyre etj. Ato renditen sipas kuptimit e ndërtimit; p.sh., tek emrat më parë vihen thënie që shënojnë llojet e sendeve a të dukurive dhe që janë zakonisht **emër + mbiemër** (si *bota shtazore, vitin e ardhshëm* etj.), thënie **emër + emër** (si *mish lope, raki rrushi, çerdhe zogjsh*) dhe thënie **emër + parafjalë + emër** (*gjizë pa kripë, fund me pala*) etj.; pastaj vijnë thënie për pjesët e sendit ose për veprimet që lidhen me të (që zakonisht përbëhet nga **emër + fjala e shpjeguar**), thënie me marrëdhënie kundri-nore që përbëhen nga **folje + emër** etj.

Bashkë me thënie janë vënë edhe disa njësi frazeologjike ose fjalë të urta që lidhen më kuptimet përkatëse. Në raste të tilla janë vënë si thënie fjali të plota, vargje të shkëputura ose pjesë nga dialogë.

Gjymtyrët e një tipi, me të cilat mund të lidhet një fjalë për të formuar thënie të ndryshme, vihen në kllapa, pa përsëritur fjalën kryesore;

p.sh. *Notë e mirë. (e keqe, e dobët). U nxori raki (kafe).* Nuk bashkohen në këtë mënyrë gjymtyrët që formojnë emërtime të pathjeshta etj.

DÍT/Ë,~A f. sh. ~Ë, ~ËT. 1. Koha kur lind dielli e derisa perëndon; drita e diellit ose moti gjatë kësaj kohe; *kund. natë. Ditë e gjatë (e shkurtër). Ditë e vrenjtur (e nxehtë). Gjithë ditën e ditës. Ditë e natë vazhdimisht, pa pushim. Mori dita u rrit, u zgjat dita. U thye dita kaloi mesdita, erdhi pasdrekja. U bë ditë u gdhi. Me ditë pa u errur ende. Ditë me shi (me diell). Dita e mirë duket që në mëngjes. / fj. u.* 2. Koha prej njëzet e katër orësh, gjatë së cilës Toka bën një rrotullim të plotë rreth boshtit të vet (edhe si masë); një kohë e caktuar brenda javës, muajit a vitit, gjatë së cilës bëhet një punë a veprimtari; një datë që lidhet me një ngjarje të caktuar; *bised. paga ditore. Ditë kalendarike. Ditë diellore* koha nga një mesditë në mesditën tjetër. *Ditë hënore* kohë prej katërmëdhjetë ditësh. *Dita e Çlirimit. Ditë mësimi (pushimi, feste). Dita e Verës/etnogr.* dita e parë e marsit, kur festohet ardhja e pranverës, kryemoti. *Dita e brumit/etnogr.* dita e enjte, kur zihet brumi për të gatuar bukët e dasmës. *Kaluan edhe dy ditë. Është punë (çështje) ditësh* do të kryhet, do të vijë etj. së shpejti. *Nga dita në ditë* a) shumë shpejt, së afërmi; b) për çdo ditë që kalon. *Dita e punës. Nxënës (student) i ditës. Ka munguar pesë ditë. Tri ditë udhë me këmbë (me kalë), I dha (ia preu) ditën. S'ka dasmë çdo ditë. / fj. u. S'shëndoshet kau ditën që do të theret. / fj. u. Kush ka ditën, të mos presë mesditën. / fj. u.* dita do shfrytëzuar që në mëngjes; punët duhen filluar në kohën e duhur e sa më parë. 3. *kryes. sh.* Pjesë e një periudhe të jetës së njeriut, të një epoke etj.; koha që lidhet me një moshë, me një epokë a periudhë të caktuar; vetë kjo moshë, kjo epokë a periudhë; koha sa jeton dikush. *Ditët e rinisë (e pleqërisë). Në ditët tona* në kohën tonë; në kohën e sotme. *Ishin ditë të bukura (të vështira, të stuhishme). I ka ditët të numëruara (të shkurtra)* edhe pak kohë i ka mbetur që të rrojë, do të vdesë së shpejti. *Marrsh nga ditët e mia! / ur. T'u bëftë dita një mijë! / ur. t'u zgjattë jeta, rrofsh sa malet!* 4. Kohë e pacaktuar; çast. *Një ditë (një ditë prej ditësh)* njëherë, dikur. *Edhe sot e kësaj dite* deri tani, deri (më) sot. *Ia gjeti ditën dikujt* ia gjeti rastin a çastin më të volitshëm për diçka. *I pret ditën dikujt* ruan rastin ta zërë ngushtë a ta ketë në dorë. *Erdhi dita e tij* erdhi koha a çasti kur dikush mund të plotësojë dëshirat a qëllimet e veta. 5. *fig.* Gjendje e caktuar e dikujt (edhe në një varg njësisish frazeologjike). *Ishte në ditë të errët* ishte në gjendje të keqe, jo në shkallën e duhur. *Ishte në ditë (në pikë) të hallit* ishte në gjendje shumë të vështirë. *Nuk është në ditë të mirë. Është në ditët e veta* është gati të lindë (për gruan shtatzënë). 6. *si mb.* DITËS (i, e). Që i përket kohës a periudhës sonë; që ka rëndësi, vlen a përdoret tashti ose që duhet zgjidhur sa më parë; që është bërë brenda njëzet e katër orëve të fundit. *Çështje (detyrë) e ditës. E vlerësonte si problem të ditës. Gjellë e ditës.*

Kur të bëhen dy ditë bashkë *iron.* asnjëherë, kurrë. **S'i ka bërë ende ditët** edhe *mospërf.* është ende i vogël e pa përvojë, s'është bërë ende për diçka. **Ç'je bërë në (më) këtë ditë!** ç'arrite në këtë gjendje të keqe!, ç'je katandisur kështu! **E bëj natën ditë.** **Bli ditë e shko** e shkon kohën kot; shtyn ditën, e zgjat kohën me zor. **Ditë pa diell** diçka jo shumë e mirë, jo aq e këndshme a e dobishme. **Në mes (në pikë) të ditës.** **Janë (ndryshojnë) si nata me ditën.** **Ditë polare** pjesë e vitit në zonat a rrethet polare, gjatë së cilës Dielli nuk perëndon për afro një gjysmë viti.

2.4 Fjalori i gjuhës shqipe, 2006

Sipas *Parathënies* “në këtë fjalor jepen pak thënie. Mjaft fjalë e kuptime të rëndomta, të njohura, që shpjegohen plotësisht me përshkrimin, me perifrazimin a me përkufizimin, nuk ilustrohen fare me thënie. Mjaft fjalë dhe kuptime të tjera kanë 1-2 thënie tipike ose specifike. Nuk vihen thënie të rëndomta, thënie që nuk sjellin gjë të re për vlerat e fjalës ose që përsëritin elemente të shpjegimit; f.v., nëse **stof,-i m. sh. -ra(t)** e shpjegojmë “cohë e plotë prej leshi, prej pambuku etj., që përdoret zakonisht për veshje të sipërme”, atëherë janë të tepërta thëniet si: **stof leshi, pantallona stof** etj.

Në fjalor janë vënë thënie që shprehin një specifikë të lidhjes ose të përdorimit të fjalës në atë kuptim, thënie që plotësojnë shpjegimin me ndonjë element semantik ose ngjyresë që nuk përfshihet në shpjegim, për shkak të shkurtimit të tij ose të bashkimit të 2-3 kuptimeve në një. Te foljet vihen thënie që dëshmojnë strukturat specifike të lidhjeve të tyre sintaksore (me trajta të shkurtra përemërore, me parafjalë të veçanta etj.). Po kështu, vihen thënie për përdorimet e figurshme, për përdorimet emërore, mbiemërore, ndajfoljore etj., si edhe kur fjalët kanë lidhje semantike a sintaksore të ndryshme nga ato që kanë fjalët e së njëjtës çerdhe. Si thënie vihen edhe disa fjalë të urta, disa lokucione gramatikore, disa emërtime të pathjeshta ose njësi frazeologjike që kanë lidhje të ngushtë me kuptimet përkatëse të fjalëve kryesore etj.

Renditja e thënieve në fjalor bëhet sipas nuancave kuptimore: në krye vihen ato thënie, në të cilat fjala e dhënë ka kuptimin e vet të plotë, konkret a më të përdorshëm. Kur brenda një kuptimi kemi nuanca, që ndahen me një vijë të pjerrët, atëherë thëniet vihen pas secilës nuancë. Gjithashtu në ndërtimin e thënieve ruhen kërkesat e normës letrare, pastërtia e fjalorit, drejtshkrimi dhe sintaksa e shqipes standarde.

Dit/ë,-a f. sh. -ë(t) 1. koha që kur lind dielli e derisa perëndon; drita e diellit ose moti gjatë kësaj kohe; *kund.* natë: *ditë e vrenjtur (e nxehtë)*; *ditë e natë* vazhdimisht, pa pushim; *mori dita* u rrit, u zgjat dita; *u*

thye dita kaloi mesdita, erdhi pasdrekja; *u bë ditë* u gdhi; *me ditë* pa u errur ende; *dita e mirë duket që në mëngjes* (fj. u.). 2. koha prej njëzet e katër orësh, gjatë së cilës Toka bën një rrotullim të plotë rreth boshtit të vet; kohë e caktuar gjatë së cilës bëhet një punë a një veprimtari; një datë që lidhet me një ngjarje të caktuar; *ditë kalendarike*; *ditë diellore* koha nga një mesditë në mesditën tjetër; *ditë nderore* kohë prej katërbëdhjetë ditësh; *ditë polare* pjesë e vitit në zonat a në rrethet polare, gjatë së cilës Dielli nuk perëndon për afër një gjysmë viti; *Dita e Çlirimit*; *Dita e Verës* (etnogr.) dita e katërbëdhjetë marsit, kur festohet ardhja e pranverës, kryemoti; *dita e brumit* (etnogr.) dita e enjte, kur zihet brumi për të gatuar bukët e dasmës; *është punë* (çështje) *ditësh* do të kryhet, do të vijë etj. së shpejti; *nga dita në ditë* shumë shpejt, së afërmi; për çdo ditë që kalon; *i dha* (ia preu) *ditën*; *s'ka dasmë çdo ditë* (fj. u.); *s'është ditë kau ditën që do të theret* (fj. u.); *kush ka ditën, të mos presë mesditën* (fj. u.) dita do shfrytëzuar që në mëngjes; punët duhen filluar në kohën e duhur. *bised.* paga ditore: *sa të vete dita?*; *ia preu ditën*. 3. kryes. sh. koha që lidhet me një moshë, me një epokë a me një periudhë të caktuar; vetë kjo moshë, kjo epokë a kjo periudhë; koha sa jeton dikush: *ditët e rinisë* (e pleqërisë); *në ditët tona* në kohën tonë; në kohën e sotme; *i mbushi ditët*; *i ka ditët të numëruara* (të shkurtra) nuk do të rrojë shumë; nuk do të zgjatë shumë; *marrsh nga ditët e mia!* (ur.); *t'u bëftë dita një mijë!* (ur.). 4. kohë e pacaktuar; çast: *një ditë* (një ditë prej ditësh) njëherë, dikur; *edhe sot e kësaj dite* deri tani, deri (më) sot; *ia gjeti ditën* (dikujt) ia gjeti rastin a çastin më të volitshëm për diçka; *i pret ditën* (dikujt) ruan rastin ta zërë ngushtë a ta ketë në dorë; *i erdhi dita* erdhi koha a çasti kur dikush mund të plotësojë dëshirat a qëllimet e veta. 5. *fig.* gjendje e caktuar e dikujt (edhe në një varg njësisht frazeologjike): *nuk është në ditë të mirë*; *është në ditë të keqe* (të errët); *është në ditët e veta* është gati të lindë (gruaja shtatzënë). **kur të bëhen dy ditë bashkë** iron. asnjëherë, kurrë; **s'i ka bërë (ende) ditët** është ende i vogël e pa përvojë, s'është bërë ende për diçka; **në ditë të hallit** (të pikës) në gjendje shumë të vështirë; **në mes të ditës** haptazi e pa frikë; sheshit (kur dikush bën diçka të keqe); **ditën për (me) diell** në mes të ditës; në sy të të gjithë njerëzve, hapur, sheshit; **ia preu ditën** (dikujt) e vrau.

Përfundime

Sintagamatikën (apo shembullsimin, matreilalin ilustrues etj.) në një fjalor e gjejmë të një zë leksikografik, si ilustrim të një kuptimi a të kuptimeve të një fjale. Fjalori ka ndërtimin e vet të brendshëm, që përbën “*teknologjinë*” ose “*morfologjinë*” e fjalorit, sipas parimesh teorike e kriteresh praktike leksikografike: ç’fjalë do të përfshijë, sa (në ç’përpjesëtim) do të pasqyrohen shtresat e ndryshme leksikore (leksiku i përgjithshëm, leksiku konkret e ai abstrakt, leksiku krahinor, terminologjia, fjalët e huaja, neologjizmat, fjalët e vjetruara, emërtimet e kafshëve, të bimëve, të veshjeve, të mjeteve, të gatesave etj.). Kjo “teknologji” e brendshme e fjalorit sendërtohet nëpërmjet “*teknikës*” leksikografike (si do të jepen fjalët, si do të renditen e si do të shpjegohen kuptimet, **si do të shënohen vlerat e njësive që shpjegohen, si do të jepen thëniet e shembujt, si do të gërshetohen e do të pasqyrohen veçoritë leksikore, gramatikore e stilistike etj.**).

“Teknika” leksikografike synon t’i japë fjalorit cilësi sa më shken-core, ta bëjë sa më ekonomik dhe lehtësisht të përdorshëm.

Zgjedhëm fjalën *ditë* për të treguar konkretisht, se fjalët më të lashta kanë leksematikë më të gjerë dhe mundësi për lidhje të reja fjalësh. Shembujt ilustrues ***ndihmojnë për zbulimin më të plotë të kuptimit*** dhe shërbejnë ***si mjet plotësues për karakterizimin e fjalës***, duke treguar sferën e përdorimit, rrethimin tipik leksiko-gramatikor, vërtetojnë vlerësimin stilistikor dhe karakteristikën gramatikore që i jepet fjalës.

Fjalorët, prej të cilëve kemi marrë lëndë për analizë, janë të llojeve të ndryshme, që dallojnë ndërmjet tyre, jo vetëm nga makrostruktura, por edhe nga mikrostruktura e zërave leksikografikë. Ky ndryshim mbartet në fjalorë edhe për thëniet (në fjalorët shpjegues kombëtarë), kurse Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, vetvetiu ndryshon sepse është fjalor jo me thënie por me shembuj.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, është fjalori me një numër shumë të madh thëniesh, numri i të cilave vjen duke u ulur në *Fjalorin e shqipes së sotme* dhe akoma më tej në *Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006*.

Shembujt në fjalorët shpjegues, kanë karakter normativ, sepse janë fjalorë të shqipes standarde. Një nga funksionet e këtyre fjalorëve është jo vetëm regjistrimi dhe kodifikimi i normës leksikore, semantike etj., por edhe zotërimi i kësaj norme edhe përmes shembullimeve.

Bibliografi

- FJALOR i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980
FJALOR i shqipes së sotme, Tiranë, 1984 / 2002
FJALOR sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004
FJALORI i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954
FJALORI i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006
THOMAI, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
SHEHU, H. (2005). Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes:
Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë.

Përmbledhje

Artikulli trajton makrostrukturën dhe mikrostrukturën te fjalorët shpjegues kombëtarë, sepse për të analizuar dhe interpretuar sintagmatikën e një fjalori së pari duhet të kemi parasysh makrostrukturën dhe mikrostrukturën e tij: (a) në një fjalor të madh, që ka shumë fjalë, shpjegime më të gjera për çdo kuptim, më shumë shënime plotësuese, më shumë thënie a shembuj; (b) në një fjalor të vogël, përkundrazi, që ka më pak fjalë, ka edhe më pak kuptime për çdo fjalë, thënie e shembuj.

Në artikull janë trajtuar dy përbërësit bazë të një fjalori shpjegues, tek të cilët do të mbështetet e gjithë puna analizuese dhe interpretuese dhe, më konkretisht te makrostruktura dhe mikrostruktura e fjalorëve shpjegues kombëtarë. Ne po japim për ilustrim pasqyrimin e fjalës ditë (si fjalë e shqipes e trashëguar nga ilirishtja që i përket fondit indoevropian) në FGjSh (1954), në FGjSSH (1980), në FShS (1984/2002) dhe në FGjSH (2006). Zgjedhëm fjalën ditë për të treguar konkretisht, se fjalët më të lashta kanë leksematikë më të gjerë dhe mundësi për lidhje të reja fjalësh. Artikulli sjell ndihmesë në leksikologjinë shqiptare.

Fjalë çelës: zë leksikografik, mikrostruktur, ilustrim i fjalës

Abstract

In this paper I have treated the macrostructure and microstructure in the national explanatory dictionaries, because for analyzing and interpreting the syntagmatic of a dictionary first of all we have to consider its macrostructure and microstructure. (a) In a big dictionary, that there are many words, broader explanations for each meaning, more supplementary notes, more phrases or examples etc. (b) In contrary, a small dictionary has fewer words, less meaning for each word, sayings and examples etc.

The dictionaries that we have taken in the analysis are of various types, that distinguish between them, as we have said, not only by the macrostructure, but also by the microstructure of lexicographic voice. This difference is carried in the dictionaries even for the sayings. In this research , i have treated two main composers of the explanatory dictionary , where all the analitical and interpreting work would be based, obviosly *the Macrostructure and the microstructure of the national explanatory dictionaries*. We are giving as illustration the reflection of the word day (as a word of albanian language inherited from illyrian language and that belongs to indoeuropean fund.) in FGjSh (1954) in FGjSSh (1980), in FShS (1984/2002) and FGjSH (2006). We have chosen the word “ day” , because the ancient words have broader lexemes and opportunities for new word connections.

Key words: lexicographic voice, microstructural, illustration of the word